


***STRATEGJITË E NXËNIES SË LEKSIKUT
TË GREQISHTES NË ARSIMIN E
MESËM TË LARTË NË SHKOLLAT
DYGJUHËSHE SHQIPTARO-GREKE***

***Departamenti i Gjuhës Greke
FGJH, UT***



PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT

Mësimi i një gjuhe të dytë ose të huaj (GJ2/GHH) është padyshim një nga çështjet më sfiduese kognitive me të cilën do të përballen shumica e njerëzve gjatë gjithë jetës, dhe shumë prej tyre argumentojnë se të mësuarit e fjalorit të një gjuhe GJ2/GHH është ndoshta aspekti më sfidues për t'u aftësuar në gjuhën e synuar.

Zotërimi i fjalorit të ri luan një rol të rëndësishëm në procesin e përvetësimit të gjuhës, pasi jo vetëm që është thelbësor në fushat e komunikimit të gjuhës amtare (GJ1), por gjithashtu vendos një bazë të mirë për të mësuar gjuhë të tjera.

Nevoja për teknika të reja dhe më të mira të mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës është gjithmonë e pranishme dhe shumë e rëndësishme për studiuesit anembanë globit.

OBJEKTIVAT

Megjithëse kërkimet në përvetësimin e fjalorit të GJ2/GHH dhe në strategjitë e të mësuarit të gjuhës kanë avancuar njohuritë tona, kërkimet e reja mbi strategjitë e zgjedhura nga nxënësit dhe efektet e tyre në aftësinë e të mësuarit të fjalorit, veçanërisht në mjediset e shkollave dygjuhëshe greko-shqiptare, mund të avancojnë njohuritë tona duke:

- a) përcaktuar llojet e strategjive që nxënësit e shkollave dygjuhëshe greko-shqiptare në Shqipëri përdorin kur përpiqen të mësojnë fjalë të reja,
- b) përcaktuar gamën e Strategjive të Mësimit të Fjalorit të përdorura nga këta nxënës dhe konsistencën e përdorimit të tyre, dhe
- c) vlerësuar efektivitetin e Strategjive të Mësimit të Fjalorit në lidhje me aftësinë e tyre të fjalorit në gjuhën greke.

GRUPET E SYNUARA DHE PALËT E INTERESIT

- Studimi aktual do të zhvillohet në një shkollë dygjuhëshe shqiptaro-greke të arsimit të mesëm të lartë në Tiranë gjatë vitit akademik 2022-2023.
- Në studim do të marrin pjesë 6 paralele, me nga 25 nxënës.
- Nxënësit i përkasin kategorive të ndryshme (pjesë e minoritetit grek në Shqipëri, pjesë e familjeve shqiptare dygjuhëshe dhe pjesë e familjeve njëgjuhëshe, por që kanë mësuar gjuhën greke përmes mësimeve në këto shkolla) dhe do të ndahen sipas niveleve gjuhësore në: fillestarë, të mesëm dhe të avancuar në gjuhën greke (sipas standardeve evropiane dhe Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës për Gjuhët).

REZULTATET E PRITSHME

- udhëzimi i qartë i strategjive të të mësuarit çon në përmirësime të motivimit dhe performancës gjuhësore;
- zbulimi i strategjive të të mësuarit të fjalorit në faza të ndryshme të zhvillimit dhe edukimi i mësuesve dhe nxënësve të gjuhës greke për përdorimin e strategjive të të mësuarit më të përshtatshme për kontekstin dhe më efektive mund të rezultojë në përmirësim të aftësisë së fjalorit dhe vetëbesim më të madh;
- kuptimi i nuancave të Strategjive të Mësimit të Fjalorit në gjuhën greke në një mjedis dygjuhësh mund t'i lejojë mësuesit të reflektojnë nëse metodologjitë e tyre të mësimdhënies janë ose jo të pajtueshme me përdorimin e strategjive të të mësuarit nga nxënësi;
- zotërimi i suksesshëm i Strategjive të Mësimit të Fjalorit mund t'u mundësojë gjithashtu nxënësve të GJ2/GHH të marrin përgjegjësinë për mësimin e tyre dhe të vetë-mbështeten dhe më pak të varur nga mësuesi i gjuhës greke

PRODUKTI/PRODUKTET E PROJEKTIT

- Një raport kryesor i cili do të paraqesë gjendjen aktuale dhe vlerësimin përkundrejt niveleve të arritjes së nivelit gjuhësor të nxënësve të arsimit të mesëm të lartë në Tiranë (sipas grupmoshave), çka do të gjenerohet nga grumbullimi, përpunimi dhe analizimi i formularëve/ pyetësorëve;
- Workshop - trajnimi me mësuesit e arsimit të mesëm të lartë në Tiranë të gjuhës së huaj (greke) mbi metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies së leksikut të gjuhës greke;
- Tavolinë e rumbullakët me ekspertë të drejtorive arsimore si dhe mësues e drejtues të shkollave greko-shqiptare të arsimit të mesëm të lartë në Tiranë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

PRODUKTI/PRODUKTET E PROJEKTIT

- Botimi i abstrakteve/kumtimeve të mbajtura gjatë Workshop - trajnimit dhe tavolinës së rrumbullakët;
- Botimi i Manualit-Udhëzuesit në gjuhën shqipe, i cili synon t'i përgjigjet pyetjeve që iu lindin arsimtarëve të arsimit të mesëm të lartë, të cilët japin mësim në këto shkolla dygjuhëshe, të cilat lidhen drejtpërdrejtë me mësimin dhe përvetësimin e leksikut - ky Manual-Udhëzues do të shërbejë si mjet bashkëpunues për të përmirësuar aftësitë e tyre, si dhe do të shërbejë si një bazë metodologjike për metodologjinë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies së gjuhës greke.

PLANI I PUNËS

Gjatë vitit të parë:

- Faza e identifikimit dhe e ndërveprimit me institucionet përkatëse arsimore të arsimit të mesëm të lartë në Tiranë si dhe firmosja e kontratës me këto institucione;
- Faza e identifikimit të nxënësve kandidatë pjesëmarrës në studim dhe kontakti me prindërit e nxënësve për të siguruar lejen e tyre (për shkak të moshës minorene të fëmijëve);
- Raporti kryesor i cili do të paraqesë gjendjen aktuale dhe vlerësimin përkundrejt niveleve të arritjes së nivelit gjuhësor të nxënësve të arsimit të mesëm të lartë në Tiranë (sipas grup-moshave).

Gjatë vitit të dytë:

- Shkrimi dhe përpilimi i Manualit – Udhëzuesit në gjuhën shqipe, i cili synon t’i përgjigjet pyetjeve që iu lindin arsimtarëve të arsimit të mesëm të lartë, të cilët japin mësim në këto shkolla dygjuhëshe, të cilat lidhen drejtpërdrejtë me mësimin dhe përvetësimin e leksikut;
- Botimi i Manualit-Udhëzuesit në gjuhën shqipe.

ANALIZA E RISKUT

1. Mungesa e disponibilitetit dhe e korrektësisë së drejtuesve/personave përgjegjës të shkollave pjesëmarrëse në studim për të nënshkruar kontratën apo për të na lejuar shpërndarjen e pyetësorëve, problematikë që mund të lindë për shkak të rregulloreve të brendshme etj.
2. Vonesa në afate nga palët e tjera, qoftë nga Shkollat apo qoftë nga Shtëpitë Botuese apo institucione që kemi parashikuar të bashkëpunojmë.
3. Mosrespektimi i afateve në përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga ana e bashkëpunëtorëve të projektit apo shkaktimi i problematikave në punën në grup, që ndikojnë direkt afatet e realizimit të projektit në fazat e ndryshme të tij.
4. Përlllogaritje të pasakta të zërave apo buxhetit apo mosparashikime

PERSONELI AKADEMIK I PËRFSHIRË NË PROJEKT

- *Ass. Prof. Dr. Sofia Delijorgji, sofia.delijorgji@unitir.edu.al*
- *Dr. Isida Foçi (Metaj), isida.metaj@unitir.edu.al*
- *Dr. Edlira Jorgaqi, edlira.jorgaqi@unitir.edu.al*
- *MSc. Aida Zoto (doktorante), aida.zoto@unitir.edu.al*

FALEMINDERIT

